

V E N D I M
Nr. 585, datë 22.11.2002

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA REHABILITIMI DHE ZGJERIMI I DEGËS DOGANORE NË MORINË,
QARKU KUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme të pronarëve, që preken nga rehabilitimi dhe zgjerimi i degës doganore në Morinë, qarku Kukës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Financave.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 1683.64 m2 tokë bujqësore, kategoria e gjashtë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 010 184 (një milion e dhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër lekësh).
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 105 000 (njëqind e pesë mijë) lekësh dhe të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Ministrinë e Financave.
 5. Fondi prej 1 010 184 (një milion e dhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri “Kosto lokale”, miratuar për projektin TTFSE, Albania nga Ministria e Financave.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.11.2002.
 7. Afati i përfundimit të punimeve të jetë brenda datës 27 korrik 2003.
 8. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË ZGJERIMIT TË DEGËS
DOGANORE NË MORINË, KUKËS**

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore, kategoria e gjashtë
Pronarët, pozicioni kadastral, sipërfaqet që do të shpronësohen dhe vlera e kompensimit

Nr.	Emri atësia mbiemri	Komuna	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja m2	Çmimi Lekë/m2	Vlera e kompensimit	Shënime
1.	Kujtim Islam Duraku	Tërthore	83/5	428,96	600	257 976 lekë	
2.	Gjemshit Shaqir Duraku Gani Shaqir Duraku Mustafë Shaqir Duraku	Tërthore	83/12	647,26	600	388 356 lekë	
3.	Rive Iljaz Duraku	Tërthore	91/4	606,42	600	363 852 lekë	
	Shuma:			1683,64		1 010 184 lekë	